



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

I nderuar ministër Shaqiri,

Në zgjedhjet parlamentare të cilat u mbajtën më 15 korrik të vitit 2020, qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut zgjodhën që të vazhdojmë ta dërgojmë shtetin përpara. Vota e qytetarëve për koalicionin që ka formuar Qeverinë e re me mandat prej vitit 2020 deri në vitin 2024 është investimi i tyre vetanak në kërkim të jetës më të mirë për vete, për familjet dhe bashkësinë e tyre. Vota e secilit qytetar është votë për mbrojtje nga KOVID-19 dhe për menaxhim të suksesshëm me krizën ekonomike-shëndetësore, votë për ekonominë e re vendore, për vende të reja të punës të paguara mirë, për shtet të së drejtës, për mjedis jetësor të pastër dhe të shëndetshëm, për infrastrukturë funksionale, për lidhje efektive brenda vendit dhe me botën, për kulturë të fuqishme nacionale sipas modelit evropian dhe arsim që i përgatit gjeneratat e reja për të tashmen dhe një të ardhme më të mirë.

Në kuptimin burimor të fjalës „ministër“ gjendet shërbimi, kujdesi dhe ndihma për qytetarët. Ju, si ministër, duhet ta kuptoni votën e qytetarit si drejtim i precizuar që vjen nga niveli më i lartë nga i cili nuk ka asnjë devijim. Duhet t'u shërbeni të gjithë qytetarëve, pa dallim të përkatësisë së tyre etnike, partiake, orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor, racor, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, përkatësisë në grupe të marginalizuara, gjuhës, statusit social, shkollimit, religjionit, bindjet politike, bindjet tjera, aftësive të kufizuara, moshës, statusit familjar apo martesor, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, statusit personal dhe statusit shoqëror. Pres që për kryerjen e detyrave tuaja dhe në realizimin e Programit për punë të Qeverisë për vitet 2020-2024, do të angazhoheni pa hezitim dhe me profesionalizëm. Kemi detyrim të shenjtë dhe thelbësor që agjendën për të cilën obligohemi para qytetarëve ta realizojmë duke investuar përpjekjet tona maksimale, përmes realizimit efektiv për arritje të rezultateve më të mira të mundshme. Kjo mënyrë nuk njeh kompromise, justifikime dhe përfshin ekspozim të vazhdueshëm para opinionit publik ku do t'i vëmë në dispozicion të gjithë mekanizmat për të ndjekur punën tonë.

Ju jeni pjesë e Qeverisë e cila hapur e prezanton punën e saj dhe është e hapur për secilin qytetar të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Unë, si Kryetar i Qeverisë do ta avancoj strukturën e kabinetit tim me qëllim që të jem Kryeministër më i hapur dhe të siguroj komunikim të dyanshëm me të gjithë qytetarët dhe bashkësitë të cilëve ju duhet ndihmë nga unë dhe shërbimet e mia, por edhe të kem mundësi që t'i pranoj dhe t'i kuptoj të gjitha idetë dhe iniciativat që vijnë nga opinioni publik.

Ju obligoj edhe juve për komunikim të rregullt dhe të hapur me të gjithë qytetarët dhe palët e interesit në shoqëri duke avancuar kanalet për përgjegjshmëri, gjithëpërfshirje dhe pjesëmarrje.

Puna e juaj çdo ditë do të ndiqet dhe matet. Nëse jeni të përkushtuar, të ndershëm dhe të përgjegjshëm do të keni rezultate të shkëlqyeshme dhe do të vazhdoni të punoni edhe më mirë për më shumë rezultate. Në të kundërtën, do të zëvendësoheni me kuadër tjetër i cili është i gatshëm të jep angazhim më të mirë dhe më të sinqertë se sa Ju. Vetëm kështu është e drejtë dhe e ndershme para



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

fjalës që ua kemi dhënë qytetarëve. Për atë, konkluzionet e para nga puna juaj do t'i sjell pas përfundimit të 100 ditëve të para të mandatit, gjegjësisht në përfundim të vitit 2020, pas të cilit janë të mundshme ndryshime kadrovike. Analizën metodologjike të realizimit të detyrave dhe punës suaj të përgjithshme do ta bëjmë çdo fundvit.

Duke ju nominuar juve për ministër në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, isha i bindur se mund të llogaris në përgjegjësinë dhe përkushtimin tuaj të plotë në kryerjen e detyrave. Pikërisht për këtë, pres rezultate të menjëhershme. Qytetarët kanë pritje, ndërsa Ju jeni në pozicion që të bëni gjithçka që është e nevojshme që Qeveria të realizojë pritjet e qytetarëve.

Si ministër i shoqërisë informatike dhe administratës, do të vazhdoni me digjitalizim dhe zbatimin e reformave kyçe të administratës publike me qëllim që ta përgatisim atë për qasje drejt hapësirës administrative Evropiane, si dhe për të siguruar shërbime më të mira dhe më të shpejta për qytetarët dhe komunitetin e biznesit. Kjo do të nënkuptojë vazhdimin e zbatimit të Strategjisë për Reformën e Administratës Publike 2018-2022 dhe Planit të Veprimit, si dhe përgatitjen e një Strategjie të re pas skadimit të asaj aktuale. Pres që ju të finalizoni Strategjinë Kombëtare të TIK-ut dhe menjëherë më pas, në koordinim me institucionet përkatëse, të filloni zbatimin e saj. Njëkohësisht, nga ju do të kërkoj të punoni së bashku me mua dhe kolegët e mi në Qeveri për të arritur politikat horizontale të qeverisë, veçanërisht në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Më konkretisht, pres nga Ju:

- Në bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet kompetente, të vazhdoni me procesin e riorganizimit dhe optimizimit të organeve të administratës shtetërore, agjencive dhe shërbimeve të inspektimit;
- Të zvogëloni vëllimin e të punësuarve në sektorin publik për 20%, nëpërmjet bashkimit të funksioneve dhe kompetencave të institucioneve, daljen në pension në moshën 64 vjeçare (me përjashtime për personelin dhe profesionet deficitare), paketave për transferim në sektorin privat ose pension të parakohshëm, etj;
- Pas miratimit të Ligjit për shërbimin e lartë udhëheqës, të siguron zbatimin e plotë të kriterëve për emërimin dhe përzgjedhjen e udhëheqësve të lartë;
- Të bashkëpunoni me ministrin e financave për zbatimin e konceptit të përgjegjësisë menaxheriale. Të krijoni sistem të ri të menaxhmentit të mesëm, të bazuar në analiza të plota dhe praktikata më të mira evropiane, i



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

cili do të sigurojë mobilitet, motivim më të fortë dhe rezultate më të mira për menaxherët e rangut të mesëm;

- Përmes ndryshimeve të duhura në rregullore, të përcaktoni qartë kompetencat e të gjitha niveleve të administratës, si për funksionet menaxheriale, ashtu edhe për secilin punonjës;
- Të krijoni dhe implementoni sistem që thekson përgjegjësinë individuale dhe vlerësimin nga ekipi, duke reformuar sistemin ekzistues 360° për vlerësimin e stafit administrativ;
- Në bashkëpunim me mua dhe Zyrën time për krijimin e grupeve të vogla të punës të përbërë nga anëtarë të komunitetit akademik, biznes sektorit, organizatave të shoqërisë civile dhe administratës për të ofruar zgjidhje të reja, inovative për problemet sistemike që vazhdojnë prej vitesh në vend;
- Të vazhdoni të përmirësoni kushtet për punonjësit e sektorit publik:
 - Të përqendrohemi në krijimin e politikave dhe mundësive për punësimin e kuadrove cilësore dhe mbajtjen e tyre në shërbimin publik, zhvillimin dhe avancimin e karrierës, motivimin, shpërblimin e duhur dhe rrogave;
 - Duke filluar nga viti 2022, të mundësoni që çdo punonjës në institucione të marrë shtesë prej 5% të rrogës nëse i arrin qëllimet që Qeveria do të vendosë si detyra të tij/saj në fillim të vitit të kaluar;
 - Në vitin e parë të mandatit të bashkëpunoni me ministren e punës dhe politikës sociale në përgatitjen e Ligjit plotësisht të ri për rrogat në sektorin publik që do të sigurojë rrogë të barabartë për punë, përpjekje dhe përgjegjësi të barabartë. Zbatimi i sistemit të ri të bëhet në faza, për një periudhë prej të paktën dy viteve;
 - Përmes ndryshimeve të duhura në rregullore, të mbështetni ministren e punës dhe politikës sociale në procesin e krijimit të politikave që do të eliminojnë mundësinë për të punuar pas moshës 64 vjeçare, me përjashtim të personelit deficitar (siç janë profesionistët e shëndetësisë dhe profesorët universitar);
 - Të përgatitni koncept të orëve fleksibile të punës të premtëve dhe mundësinë për të zvogëluar numrin e orëve të punës gjatë javës;
- Të bashkëpunoni me ministrin e sistemit politik dhe marrëdhënieve ndërmjet bashkësive për zbatim efikas dhe cilësor për përmirësimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në të gjitha institucionet e sektorit publik;
- Të vazhdoni me zbatimin e masave për përforsimin e transparencës aktive të punës së institucioneve:
 - Në gjashtë muajt e parë të mandatit të udhëheqni modernizimin e web-faqeve të ministrive dhe Qeverisë dhe të rrisni numrin dhe cilësinë e të dhënave dhe deri në vitin 2024 të krijoni politika për një standard të vetëm për shfaqjen dhe qasjen e informacionit në web-faqet e



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

- institucioneve të sektorit publik, përfshirë mënyrën standarde të kërkimit dhe qasjen e tyre për personat me aftësi të kufizuara;
- o Në vitin e parë të mandatit të përgatitni Strategji të re të të dhënave të hapura që do të përcaktojë qëllime të qarta dhe më të larta për transparencë për të gjitha institucionet dhe udhëheqësit e tyre;
- Të vazhdoni digjitalizimin e punës së administratës dhe shërbimeve për qytetarët dhe komunitetin e biznesit:
 - o Në vitin e parë të mandatit të krijohet institucion qendror për koordinimin dhe zbatimin e procesit të digjitalizimit në shoqëri, por edhe mbështetjen e plotë të IT-së për institucionet shtetërore;
 - o Në dy vitet e para të mandatit të sigurohet zgjidhje e përshtatshme e sistemit për komunikimin e përgjithshëm elektronik ndërmjet dhe brenda institucioneve;
 - o Deri në fund të vitit 2021 të mundësoni të paktën 30% e organeve të administratës shtetërore të kenë sistem elektronik për automatizimin e procedurave administrative dhe deri në fund të vitit 2024 sistemi të futet në të gjitha organet e administratës shtetërore;
 - o Punë aktive për digjitalizimin e mëtejshëm të shërbimeve dhe disponueshmërinë e tyre përmes Portalit kombëtar të shërbimeve elektronike;
 - Të mundësoni zbatimin e plotë të marrëveshjes së nënshkruar me kompaninë botërore MasterCard për zhvillimin dhe zbatimin e certifikatave digjitale dhe inovative për vërtetimin të identitetit;
 - Të vazhdoni puna për hapjen e Një qendër për shërbim (NjQSh) në çdo qytet të vendit, duke ndjekur shembullin e NjQSh në Shkup;
 - Deri në fund të vitit 2020, të përgatitni studim fizibiliteti për ndërtimin e rrjetit optik kombëtar për transport;
 - Deri në fund të vitit 2023 të sigurohet mbulim i plotë të paktën i një qyteti me sinjal 5G dhe deri në fund të mandatit, mbulim të 70% të korridoreve kryesore dhe rrjetit rrugor në vend. Në këtë mënyrë, të siguroni kontroll dhe rregullore të përshtatshme që do të garantojë sigurinë e qytetarëve, shtetit dhe infrastrukturës kritike;
 - Të mbështetni reformat në media të propozuara nga sektori i medias, bazuar në parimet dhe standardet evropiane;
 - Të bashkëpunoni me Qeverinë dhe mediat për zhvillimin e radios dhe televizionit kombëtar si një transmetues publik;
 - o Të bashkëpunoni me Qeverinë dhe mediat për zhvillim të Strategjisë për trajtimin e lajmeve të reme;
 - o Të përkrahni dhe promovoni vazhdimisht lirinë e fjalës dhe lirinë e shprehjes, pluralizmin mediatic dhe vetërregullimin;
 - o Të siguroni mbështetje financiare dhe jo-financiare për median e shkruar dhe televizionet lokale, rajonale në një mënyrë të



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

vazhdueshme dhe jodiskriminuese, në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

- Të zbatoni aktivitete të tjera në përputhje me zotimet dhe Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020 – 2024

Njëkohësisht, si ministër i shoqërisë informatike dhe administratës në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga Ju pres:

- Të jeni gardiani i parë i Kushtetutës dhe ligjeve dhe të siguroni që Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë të përmbush të gjitha detyrimet ligjore, që të gjithë bartësit e funksioneve publike dhe zyrtarët që punojnë nën juridiksionin tuaj të jenë njësoj të përgjegjshëm ndaj ligjit dhe Kushtetutës dhe se Kushtetuta dhe ligjet do të zbatohen njëjtë për të gjithë;
- Të jeni shembull i qeverisjes së mirë dhe të siguroni që zyrtarët publik dhe zyrtarët që punojnë nën juridiksionin tuaj t'u përmbahen standardeve më të larta të qeverisjes së përgjegjshme dhe etike;
- Të siguroni Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë të përgjigjet në kohë, në mënyrë të drejtë, efikase dhe efektive të zgjidh çështjet dhe procedurat e qytetarëve dhe personave juridik, duke justifikuar dhe fituar besimin e qytetarëve dhe të opinionit publik;
- Të vazhdoni zbatimin dhe përmirësimin e politikave të transparencës dhe llogaridhënies;
- Të jeni i hapur dhe gjithëpërfshirës ndaj qytetarëve, publikut profesional, shoqërisë civile dhe opozitës në krijimin dhe zbatimin e politikave publike në mënyrë që të siguroni politika cilësore të bazuara në prova dhe konsensus të shoqërisë;
- Të siguroni që burimet shtetërore të mos përdoren për qëllime partiake dhe zgjedhore dhe që zyrtarët administrativ dhe punonjësit e sektorit publik të mos jenë subjekt i ndikimit partiak;
- Të promovoni barazinë gjinore dhe përfaqësimin e drejtë dhe të keni parasysh karakterin multietnik të vendit.

Bashkëpunoni me të gjithë punonjësit dhe përdorni të gjitha potencialet e administratës publike. Në të gjitha veprimet tuaja, të jeni shembull për ata me të cilët



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

punoni dhe për qytetarët për të cilët punoni. Respektoni Kodin etik për anëtarët e Qeverisë dhe mbajtësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria dhe promovoni vlerat etike. Në fund të mandatit tonë në vitin 2024, si rezultat i ndryshimeve pozitive që ne do të bëjmë, Maqedonia e Veriut të jetë vend ku qytetarët duan të jetojnë dhe të kontribuojnë në përmirësimin e saj të vazhdueshëm. Qytetarët e presin këtë nga ne.

Ju uroj fat, shëndet dhe mandat të suksesshëm.

Sinqerisht i juaji,
Zoran ZAEV

Ministër i shoqërisë informatike dhe administratës në republikën e maqedonisë së veriut
Jeton SHAQIRI